



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 863/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Adnan Gashi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Adnan Gashi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtime, me shenjën ZL.Anr.863/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.863/2017 me datën 10.11.2017, nga parashtruesi i apelit Adnan Gashi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtime, i cili pretendon se në vendvotimin 2202e/01R ka mospërputhje të rezultateve me të cilën në raportin e publikuar nga KQZ para shpalljes së rezultatit përfundimtar ka pasur 8 vota, kurse pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ ka më pak vota. Në vendvotimin 2202E/03D në fshatin Petrovë, komuna e Shtimës, pretendon se i mungojnë votat e familjarëve të tij me të cilën i rezultojnë vetëm 3 vota.

Kërkon nga PZAP-i që të bëhet rinumërimi i votava në vendvotimet e cekura në apel.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve të apeluesit, gjeti se apeli është i pabazuar sepse nuk ka ofruar prova siç pretendon se i ka pasur 8 vota kurse në rezultatin përfundimtar i kanë

dalur më pak vota. Prandaj Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si i tillë apeli u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.863/2017 më datën 12.11.2017.



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*